

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve

Nëse dikujt i lindë fëmijë, duhet menjëherë lindjen ta paraqes në Zyrën e Gjendjes Civile. Ndërsa te çiftet e martuara, e drejta e përkujdesjes së fëmijës është e rregulluar automatikisht, çiftet e pa martuara duhet vetë të përkujdesen për këtë.

Njoftimi për lindjen

Për lindjen e secilit fëmijë duhet të njoftohet Zyra Rajonale e Gjendjes Civile (Regionales Zivilstandsamt). Kujdes: Se cila zyrë e gjendjes civile është përgjegjëse, varet nga vendi i lindjes e jo nga komuna ku banojnë prindërit. Nëse lindja bëhet në spital, spitali zakonisht ia përcjell dokumentet zyrës përgjegjëse të gjendjes civile. Nëse lindja nuk bëhet në spital (por, për shembull në shtëpi), lindja e fëmijës duhet të lajmërohet brenda 3 ditëve. Zyra përgjegjëse e gjendjes civile do t'ju informojë se cilat dokumente kërkohen. Fëmijët e lindur në Zvicër nuk e marrin automatikisht shtetësinë zvicerane.

Pranimi e atësisë

Kur çiftet e martura kanë fëmijë, automatikisht bashkëshorti evidentohet si baba. Nëse bashkëshorti dyshon që është i ati, mund ta kontestoj atësinë përmes gjyqit. Nëse prindërit nuk janë të martuar, babai i fëmijës nuk regjistrohet automatikisht si baba. Ai mund ta pranoj atësinë para ose pas lindjes në zyrën rajonale të gjendjes civile në komunën ku banon. Nëse babai i shmanget pranimit të atësisë, nëna mund të ia kërkoj këtë përmes gjyqit.

Përkujdesja prindërore

Prindërit kanë të drejta dhe detyrime, për mirëqenjen e fëmijëve (përkujdesja prindërore). Për shembull kësaj i përkasin edukimi, apo përkujdesja financiare. Prindërit ligjërisht i përfaqësojnë fëmijët e tyre deri sa ata bëhen 18 vjeç. Nëse prindërit janë të martuar, automatikisht i marrin të drejtat dhe detyrimet e njëjta ndaj fëmijës. Nëse nuk janë të martuar, babai së pari duhet ta pranoj fëmijën. Pastaj prindërit vullnetarisht mund ta bëjnë një deklaram me shkrim për përkujdesje prindërore të përbashkët (gemeinsame elterliche Sorge). Kjo bëhet bashkë me pranimin e fëmijës në zyrën rajonale të gjendjes civile ose më vonë te zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve (Kindesschutzbehörde, KESB) në gjykatën familjare të qarkut. Nëse prindërit e pamartuar nuk mund të bien dakord për kujdestarinë, do të vendosë autoriteti për mbrojtjen e fëmijëve. Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për mbështetje, kontaktoni një nga qendrat përgjegjëse të këshillimit për këtë.

Mbajtja

Nëse prindërin janë ndarë, ata edhe më tutje janë të detyruar të përkujdesen për fëmijën (mbajtja, Unterhalt). Ata duhet ta rregullojnë mes veti çështjen financiare dhe përkujdesjen ndaj fëmijës. Pagesa për mbajtje ndahet në mes babait dhe nënës. Nëse dhe sa duhet të paguajë njëri prind, varet nga gjendja e tyre ekonomike dhe pjesa e tyre e përkujdesjes për fëmijën. Nëse nuk është i mundur pajtimi, duhet shkuar në gjykatë. Nëse partneri që është i detyruar të paguajë nuk paguan, mund të aplikohet për ndihmë në komunën ku banohet. Kjo ndihmon në kërkesën e shumës së duhur dhe/ose paguan paraprakisht kontributet e mbështetjes (alimentacionin) nëse ka një kërkesë për to (Alimentenbevorschussung).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.ola-aargau.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/te-drejtat-dhe-detyrat-e-prinderve